



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 121, datë 15.07.2019

PËR
VERIFIKIMIN E KUSHTEVE DHE KRITEREVE LIGJORE PËR REKRUTIMIN SI
GJYQJAR TË KANDIDATIT, Z. ERVIN SULAJ

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 35 në lidhje me nenin 32 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vendimet e Këshillit nr.75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” dhe nr. 82, datë 05.06.2019 “Për caktimin e relatorit për verifikimin e kushteve dhe kriterëve për secilin kandidat për gjyqtar të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018”, në propozimin e relatorit pranë Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

VENDOSI:

1. Të kualifikojë për emërim, kandidatin Ervin Sulaj, i diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2017 – 2018 dhe vijimin e procedurës së emërimit të tij si gjyqtar.
2. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet kandidatis.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR